



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETETEVE

PROJEKT VENDIM

Nr 13.datë 08.03.2023

Rishikim i vendimit të KB nr 70, datë 28.10.2022, “Dhënie pëlqimi në parim për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 0,2625 Ha, e llojit “Arë”, pasuria nr 539/6, Zk nr 1329, ndodhur në fshatin Bushat, Bashkia Vau Dejës”.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/l”(ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vërtëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, në VKM nr 246 dt 31.03.2011. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin 68, dt 31.03.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, ligji nr 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, ligji nr 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, Udhëzimi nr 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës që në mbledhjen e radhës të:

VENDOSI

1. Miratimin në parim për dhënien në përdorim me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 0.2625 Ha, pasuria nr 539/6, e llojit “Arë”, ndodhur në Zk nr 1329, fshati Bushat, Bashkia Vau Dejës.
Kjo pasuri jepet në përdorim me qëllim shfrytëzimin e saj për veprimtari bujqësore.
2. Efektet: Jep efekte pozitive në komunitet, duke hapur vende të reja pune si dhe duke siguruar të ardhura për Bashkinë, të cilat kthehen më pas në investime publike.
3. Tarifa dysHEME e qirasë vjetore dhe afati i dhënies me qira të jetë në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

4. Pas miratimit në Këshillin Bashkiak dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, do vazhdohet me procedurat e konkurimit, me të gjithë elementet përbërës të saj deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Kristian SHKRELI

KRYETARI
Mark BABANI

Konceptoi: Armand Filipi

Miratoi: Ndoc Baqli

